



Datë: 02.10.2025
Numër Protokolli: 6544/2025

A.nr.1596/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar Malsore Gashi–Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi-në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 1596/2025 të datës 13.08.2025 e parashtruar nga ankuesja L.Th-G, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 02.10.2025, mori këtë;

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr. 1596/2025 e datës 13.08.2025 e parashtruar nga ankuesja L.Th-G.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile L.Th-G, (tutje referuar vetëm Ankuese), më datë 13.08.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5458/2025, e regjistruar nën shenjen A. Nr.1596/2025,në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimore së jam e punësuar në Komunën e Obiliqit, në pozitën Zyrtare për Bibliotekë dhe se jam dëmtuar në pagë nga hyrja në fuqi e Ligjit për Pagat.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit ndërsa Këshilli më datën 22.08.2025, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Obiliqit, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5458/2025 të datës 13.08.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit për ankuesen; Akt Emërimit të datës 09.06.2025, për ankuesen; Vendimi me numër protokolli 02-110-03-1514925, të datës 09.06.2025; Kërkesën e datës 06.06.2025; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1596/2025,

të datës 22.08.2025; Akt Emërimit të datës 11.03.2024; Akt Emërimit të datës 08.08.2023; Diplomë me numër protokolli 018/12, e datës 04.08.2021, për ankuesen e lëshuar nga Kolegji Globus; Listat e pagave për ankuesen.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesja, konstatoi se ankesa është e parakohshme, sepse:

Nga provat e lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokolli 02-110-03-1526525, të datës 09.06.2025, është e punësuar në Komunën e Obiliqit, dhe se e njëjta mbanë pozitën e punës Zyrtare për Bibliotekë, në Drejtorinë e Kulturës Rinis dhe Sportit.

Më datë 13.08.2025 ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimore së jam e punësuar në Komunën e Obiliqit, në pozitën Zyrtare për Bibliotekë dhe se jam dëmtuar në pagë nga hyrja në fuqi e Ligjit për Pagat.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *"1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor,* Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Obiliqit, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procedimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, (e aplikueshëm deri me datë 21.02.2024), por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë

Andaj, duke qenë se organi përkatës i punësimit nuk ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës sikurse përcaktohej me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit duke iu referuar dispozitave të nenit 34 të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në fuqi nga data 28.02.2024, thekson faktin se *institucionet janë të obliguara që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje*, andaj, mbi këtë bazë, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankueses, për kategorizimin e pozitës së sajë, është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior. Rrjedhimisht, e njëjta është e

papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës se theksuar më lart, ankueses do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tyre të punës.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 1596/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, L.Th-G;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.